



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Data: ____/____/2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

:

OBJEKTI I PROKURIMIT : “REHABILITIM I PJESSHËM I KANALIT USHQYES TË DIGËS SË REZERVUARIT MBOLAN

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) : CPV):
45000000-7 Punë ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT : 7 666 666.69 (shtate milione e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtë presje gjashtedhjetë e nente)leke pa Tvsh

Argumentimi : Përlogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar **projekt preventivit**.

Fondi limit është percaktuar në bazë të preventivit të punimeve të hartuar nga specialistet e fushës

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Berat (Njësia e Prokurimit), bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, projekt – preventivin dhe grafikun e punimeve, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;;.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen që ka në këtë bashkim operatorësh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, bëhet duke iu referuar parashikimit në nenin 41 të Ligjit nr. 1009/2009 i ndryshuar : Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:

a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik;

b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;

iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin e fundit (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësiti Administrativ përkatës ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetin sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik,duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm,ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
2. Situacionin përfundimtar të objektit;
3. Fatura tatimore përfundimtare.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posacme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor;

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjië, ne baze te VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Punime të përgjithshme ndërtimi

- NP-1 – Punime gërmimi në tokë – Klasifikimi A
- NP-5 – Punime nëntokësore, ura e vepra arti – Klasifikimi A
- NP-7 – Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje – Klasifikimi A
- NP-9 – Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime – Klasifikimi A

Punime speciale ndërtimi

- NS-1 – Punime për prishjen e ndërtimeve – Klasifikimi A
- NS – 18 A Punime topogjeodezike

***Shënim :** Operatorët e huaj duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë institucionit përkatës siç përcaktohet në “Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e miratuar me VKM – në Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Mos paraqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

-Operatorët ekonomike duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates

Licencat për punimet e pergjithshme te ndertimi dhe punimet speciale të ndërtimit janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për këtë kategori licence.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë :

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP - 1	Punime gjurmimi në tokë	Në këtë kategori Përfshihet gjurmim dheu, mbushje-ngjeshje, si dhe punime sistemimi të dherave.	A (0-20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar
NP - 5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Në këtë kategori përfshihen zërat mur mbajtës ;urë automobilistike – ura këmbësore kaskadë/shuarës energjie –;vepra arti të dëmtuara.	A (0-20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar
NP - 7	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	Ky është një nga kategoritë më të drejtpërdrejta për objektin, pasi kemi rehabilitim të një kanali ushqyes/vaditës , veshje të kanalit me betonarme etj.	A (0-20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar
NP - 9	Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime	Gabionet dhe punimet e sistemit/mbrojtjes hidraulike lidhen me NP-9.	A (0-20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar

NS - 1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Lidhet me Prishje dhe shkulje veprash arti të dëmtuara	A (0-20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar
NS - 18	Punime Topogjeodezike	Lidhet me piktetimin e objektit,	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar

Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik per secilin pjesetar te stafit teknik duhet te paraqese:

Kontratë pune/, Diplomën Universitare,

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e shkronjave a) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514 datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

-Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve,

Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor inxhinieri nderimi, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës së kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Hartimi i këtyre kriterëve është vendosur edhe mbi bazën e parashikimeve të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar., sipas të cilës, “Drejtues teknik”- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që janë është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Gjithashtu, hartimi i kriterëve për personelin kryesor si dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar është hartuar në përputhje me nenin 39/6/c/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi për realizimin e saktë të kuotave të themeleve, kuotave të shtresave etj.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, te pajisur me deshmi profesionale te leshuara nga shoqëri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretishtsi më poshtë :

Teknike ndertimi	1
Karpentierë	3
Hekurkthyes	3
Betonues	4
Muratore	2
Punëtorë të përgjithshëm	4
Total	17 (shtatembdhjete)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e mesiperme, germa b) janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **1 Teknik i mesëm ndërtimi** – konsiderohet i mjaftueshëm për mbështetjen teknike dhe organizimin e proceseve të punës në një objekt me këtë volum dhe kohëzgjatje.
- **4 Betonues** – kërkohen për realizimin paralel dhe në kohë të punimeve të betonit/betonarmesë, ku vetëm veshja e kanalit (**179.70 m³**) dhe dhëmbët shuarës (**44.60 m³**) përbëjnë **224.30 m³**, pa përfshirë betonin e murit mbajtës, urave dhe kaskadës. Numri 4 mundëson formimin e një skuadre pune të përshtatshme për përballimin e këtyre volumeve brenda afatit 3-mujor.
- **2 Hekurkthyes** – kërkohen për përgatitjen dhe montimin e **5.37 ton armaturë**, duke siguruar realizimin e punimeve të armimit paralelisht me procesin e betonimit.
- **4 Specialistë ndërtimi** – kërkohen për mbështetjen e proceseve të ndryshme ndërtimore dhe të veprave të artit, duke mundësuar zhvillimin e njëkohshëm të disa fronteve të punës.
- **2 Muratorë** – kërkohen për realizimin e murit mbajtës dhe punimeve ndërtimore të lidhura me veprat e artit; numri 2 mundëson krijimin e një skuadre minimale të specializuar.

- **2 Karpentierë** – kërkohen për përgatitjen, montimin dhe çmontimin e kallëpeve të elementeve betonarme të kanalit, murit mbajtës, urave dhe kaskadës. Dy punonjës sigurojnë një skuadër të përshtatshme për realizimin e këtyre proceseve në afatin e përcaktuar.

2.3.7 Operatorët ekonomik duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve, si më poshtë :

Eskavatorist	1
Manovrator	1
Shoferë kamioni	2
Total	4 (kater)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten :

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi të Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200 datë 16.05.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të përkojë me kërkesat e profilin të deklaruar për çdo punonjës.
- Gjatë fazës së ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit eskavatoristë/manovrator, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë : emër/mbiemër, profilin e punës, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmërisë së saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atëherë eskavatorist / buldozeristët, automakinistët, dhe shoferët nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E ofertues.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200 datë 16.05.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ngurta “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transportin e mbetjeve të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, ose marrëveshje e vlefshme bashkëpunimi me operator të licensuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se : “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën I/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se : “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538 datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” : “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 24 (njetete e kater) punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërsa ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzoj pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor për muajin e fundit.

b) List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, ç), të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht : Vendorsja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve.

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I FUQISË PUNËTORE

Për realizimin e punimeve brenda afatit kontraktual prej 3 muajsh është parashikuar një fuqi maksimale prej 24 personash, duke përfshirë stafin teknik, fuqinë punëtore të specializuar, operatorët e makinerive dhe drejtuesit e mjeteve të transportit.

Përcaktimi i fuqisë punëtore është bërë në funksion të volumeve të preventivit dhe domosdoshmërisë së zhvillimit paralel të disa fronteve të punës.

Volumet kryesore përfshijnë 1,140 m² pastrim dhe prerje bimësie, 52 copë pemë, 269.4 m³ gjurmime, 57.4 m³ mbushje dhe ngjeshje, 179.7 m³ veshje kanali me beton M200, 44.6 m³ beton për dhëmbët shuarës, 5.37 ton armaturë, 24 m³ gabiona dhe 12 ml mur mbajtës, krahas realizimit të 1 ure automobilistike, 2 urave këmbësore, kaskadës shuarëse, riparimit të rrugës dhe punimeve të tjera ndihmëse.

Për mbikëqyrjen dhe drejtimin e specializuar të punimeve parashikohet angazhimi i 1 Inxhinieri Ndërtimi dhe 1 Inxhinieri Hidroteknik, të mbështetur nga 1 teknik/topograf. Për realizimin e punimeve mekanike dhe transportin parashikohen 2 shofere makinerish dhe 2 shoferë kamioni, ndërsa fuqia tjetër punëtore përbëhet nga karpentierë, hekurkthyes, betonistë/muratorë dhe punëtorë të përgjithshëm.

Volumi prej rreth 224.3 m³ punime betoni, së bashku me 5.37 ton armaturë, punimet e gabioneve, murit mbajtës dhe veprave të artit, kërkon organizimin paralel të ekipeve të kallëpeve, armaturës, betonimit dhe punimeve të tokës. Gjithashtu, volumi prej 269.4 m³ gjurmime dhe transporti i materialeve kërkojnë angazhimin e operatorëve dhe drejtuesve të mjeteve pa ndërprerë frontet e tjera të punës.

Për një periudhë prej rreth 65 ditësh pune efektive, fuqia maksimale prej 24 personash siguron një kapacitet teorik prej 1,560 ditë-person, duke mundësuar hapjen e disa fronteve të punës në mënyrë të njëkohshme dhe krijimin e rezervës së nevojshme për ndërprerjet teknologjike, furnizimin me materiale dhe kushtet e kantierit.

Në këto kushte, fuqia maksimale prej 24 personash konsiderohet e përshtatshme për realizimin e volumeve të parashikuara dhe për respektimin e afatit kontraktual prej 3 muajsh.

<i>Fronti i punës</i>	<i>Persona</i>
<i>Fronti 1 – Veshje kanali / betonime</i>	7
<i>Fronti 2 – Armaturë + kallëpe për veprat e artit</i>	5
<i>Fronti 3 – Gabione / mur / sistemime</i>	4
<i>Shofere makinerish</i>	2
<i>Shoferë kamioni</i>	2
<i>Staf teknik: 2 inxhinierë + topograf</i>	3
<i>Punëtor mbështetës sipas frontit</i>	1
TOTAL MAKSIMAL	24

Nr.	Kategoria / Specialiteti	Nr. persona	Detyra kryesore
1	Inxhinier Ndërtimi	1	Drejtim teknik i punimeve konstruktive, beton, armaturë, ura, mur mbajtës
2	Inxhinier Hidroteknik	1	Kanal, kuota/pjerrësi, kaskadë, disiplinim dhe shuarje energjie
3	Topograf	1	Piketim, kuota dhe kontroll gjeometrik
	Drejtuues teknik	1	Për mbështetjen teknike dhe organizimin e proceseve të punës në një objekt me këtë volum dhe kohëzgjatje.
4	Eskavatorist	1	Gërmime, sistemime dhe ngarkime
5	Manovrator	1	Mbushje, nivelim dhe ngjeshje
6	Shoferë	2	Transport dheu, inerte dhe materiale
7	Karpentierë	3	Kallëpe për kanal, ura, mur dhe vepra arti
8	Hekurkthyes	3	Përgatitje dhe montim armature
9	Betonues	4	Punime betoni, kanal dhe vepra arti
	muratorë	2	mur mbajtës
10	Punëtorë të përgjithshëm	4	Gabione, asistencë, materiale, pastrim dhe sistemime
	TOTAL	24 persona	

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores ”Për sigurinë në kantier”.

- Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për *sigurinë në kantier* miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi

zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjes së shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga zjarri apo çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 18 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	1 autovinç/kamion me vinç	1 cope	Në pronësi ose me qera
4	Ekskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Minieskavator deri ne 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Fadromë me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Çekic pneumatik	2 copë	Në pronësi ose me qera
9	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator Betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
11	Armaturë Kallëperi betoni	500 m2	Në pronësi ose me qera
12	Pompë Uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
13	Matrapik	1 copë	Në pronësi ose me qera
14	Motosharrë për prerje bimësie	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Aparat për kthim dhe prerje hekuri (Tranxhë hekuri)	1 copë	Në pronësi ose me qera

- a) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:
- Kokore + Jelekë fosforeshentë – *jo më pak se 24 copë*
 - Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 10 copë*
 - Prozhektorë ndriçimi natën – *jo më pak se 5 copë*
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 10 copë*

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet :

Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”. “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknike vjetor dhe atë periodik”. Ligji nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se : “Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij” ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim“.Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Kërkesa për disponimin e automjeteve, makinerive dhe pajisjeve është përcaktuar në përputhje me **natyrën dhe volumin e punimeve të preventivit, mënyrën e realizimit të tyre dhe afatin 3-mujor të zbatimit të kontratës**. Sasitë e kërkuara janë vlerësuar në mënyrë që të mundësohet zhvillimi paralel i proceseve kryesore të punës dhe përfundimi i tyre brenda afatit kontraktor.

- **1 kamionë vetëshkarkues 10–18 ton** – kërkohen për transportin dhe largimin e dherave nga gërmimet, transportin e materialeve të mbushjes dhe materialeve të tjera të nevojshme. Dy mjete mundësojnë transportin paralel dhe shmangien e ndërprerjeve të punimeve të gërmimit dhe mbushjes.
- **1 autovinç/kamion me vinç** – kërkohet për ngritjen, transportimin dhe pozicionimin e materialeve dhe elementeve të ndryshme gjatë ndërtimit të urave, murit mbajtës, kaskadës dhe veprave të tjera të artit.
- **1 kamionçinë deri në 3.5 ton** – kërkohet për transportin e materialeve, veglave, pajisjeve dhe furnizimeve të vogla në kantier dhe në frontet e ndryshme të punimeve.
- **1 ekskavator me goma** – kërkohet për punimet e gërmimit, ngarkimit dhe sistemimit të dherave, veçanërisht në zonat ku kërkohet manovrim dhe lëvizje e shpejtë përgjatë aksit të kanalit.
- **1 minieskavator deri në 5 ton** – kërkohet për punime në hapësira të kufizuara, punime pranë veprave ekzistuese, pastrime dhe ndërhyrje të lokalizuara ku makineritë e mëdha nuk mund të operojnë me efikasitet.

- **1 fadromë me goma** – kërkohet për ngarkimin, sistemimin dhe transportin në distanca të shkurtra të materialeve dhe dherave, si dhe për përgatitjen e fronteve të punës.
- **1 çekiç pneumatik** – kërkohet për punimet e prishjes së veprave të artit të dëmtuara dhe elementeve të forta ekzistuese, të parashikuara në preventiv.
- **1 autobot uji** – kërkohet për furnizimin me ujë dhe lagështimin e materialeve gjatë punimeve të mbushjes/ngjeshjes, si dhe për kontrollin e pluhurit dhe mirëmbajtjen e kushteve të punës në kantier.
- **2 vibratorë betoni** – kërkohen për konsolidimin dhe ngjeshjen e betonit gjatë realizimit të veshjes së kanalit, dhëmbëve shuarës, murit mbajtës, urave dhe kaskadës. Dy pajisje mundësojnë vijimin e punimeve edhe në rast të zhvillimit paralel të fronteve të betonimit.
- **500 m² kallëpe/armaturë kallëperi për beton** – kërkohen për realizimin e elementeve betonarme të kanalit dhe veprave të artit. Sasia është përcaktuar për të mundësuar realizimin e kallëpeve në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas fazave të betonimit gjatë afatit 3-mujor.
- **1 pompë uji** – kërkohet për largimin e ujërave nga frontet e punës dhe për mbajtjen në kushte të përshtatshme të zonave ku realizohen gërmime, betonime dhe punime të tjera në kanal.
- **1 matrapik** – kërkohet për punimet e prishjes, çarjes dhe heqjes së materialeve të forta gjatë rehabilitimit të veprave ekzistuese dhe për ndërhyrje të lokalizuara në kantier.
- **1 gjenerator** – kërkohet si burim alternativ energjie për pajisjet dhe mjetet elektrike në rast të mungesës ose pamjaftueshmërisë së energjisë elektrike në frontet e punës.
- **1 motosharrë për prerje bimësie** – kërkohet për realizimin e zërit të preventivit për prerjen e bimësisë dhe shkuljen e rrënjëve, përfshirë punimet përgatitore përgjatë kanalit.
- **1 aparat për prerje dhe kthim hekuri** – kërkohet për përpunimin e armaturës së hekurit të vjaskuar **Fi 10 mm**, ku në preventiv parashikohen **5.37 ton** hekur përforcues në formë zgare 20×20 cm.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës

- g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet janë bazuar në zerat e punimeve dhe mundësinë për të patur akses në sheshin e ndërtimit.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë si dhe të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalent, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit SSH EN ISO 14001:2026 (e vlefshme) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018 / ISO 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

.

Çertifikatat sa më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standartet e menaxhimit të mjedisit

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:*Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes(projektuesit), bashkëngjitur DST ne SPE.*

Argumentimi:*Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në Nr.629, datë 15.07.2015”PËR MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.